

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"CONSILIJUM GROUP" SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 25/01/2018 (dymijë e tetëmbëdhjetë) personi i me poshtem:

- **Florjan Malaj**, atësia Nuredin, e datelindjes 25-09-1992, lindur në Fier dhe banuese në Fier, shtetas Shqiptare, madhore e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit nr. Personal 033244990;

ne cilesine e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire pivate, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosi te themeloje shoqerine tregtare, me perjegjesi te kufizuar, me emertimin "**CONSILIJUM GROUP**" SHPK.

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1
EMRI**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me perjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin "**CONSILIJUM GROUP**" SHPK.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zoteron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria "**CONSILIJUM GROUP**" ka si objekt të veprimtarise te saj, zhvillimin e aktiviteteve si me poshtë te percaktuara :

- Sherbime promovimi, marketingu ndermjetesim dhe konsulencë tregtare;
- Realizimin e ofertave dhe sherbimeve ne sektorin e marketingut, telemarketingut, teleshitjes per tu realizuar nepermjet telefonit, kompjuterit dhe formave te tjera te komunikimit;
- Ofrim i kurseve te perqatitjes profesionale ne kryerjen e aktiviteteve te marketingut, telemarketingut, teleshitjes per tu realizuar nepermjet telefonit, kompjuterit dhe formave te tjera te komunikimit;
- Shoqeria mund te angazhohet gjithashtu ne cfaredo lloj aktiviteti tjeter qe nuk ndalohet me ligj, qofte drejtpërdrejtë ose duke kontraktuar pale te treta;
- Ka te drejte te kryej dhe cdo gje tjeter pa kufizim qe lidhet me aktivitetin sa me siper.



Neni 3
Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per një afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumi të perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqeria "CONCILIO GROUP" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKR-se.

Neni 4
Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën: **Rruga Dervish Hima, Shk1, K12. Ap.91, Tiranë, Shqipëri.**
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikës se Shqipërisë, ne përputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridikzionit te vendit perkates.

KREU III

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **1.000 Lek** (njëmije lek), i barabarte me 1 (një) kuote. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë është ne raport me kontributin e dërdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permblledhur sipas grafikut te meposhtem:


| Nr. | Emri i Ortakeve | Kuota | Kontributi i ortakeve ne kapital (leke) | Perqindja ne kapital |
|-----|------------------------------|----------|-----------------------------------------|----------------------|
| 1. | Florjan Nuredin Malaj | 1 | 1.000 | 100 % |
| | Totali | 1 | 1.000 | 100 % |

- 5.3 Kontributet sa me siper janë nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakut te vetem te shoqerise.

Neni 6
Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëvenë përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

- 6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh që te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

2 

KREU IV

Neni 7

Transferimi i Kuotave

- 7.1 Transferimi (perfshire shitje dhe ose dhurimin dhe ose cedimin dhe ose kalimin) inter vivos te kuotave te shoqerise tek pale te treta i nenshtrohet te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere ekzistues, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te parashikuara ne nenin 7.2 me poshte.
- 7.2 Ne rast se nje ortak (ketej e tutje i quajtur Ofruesi) kerkon te transferoje disa ose te gjitha kuotat ose kontributet e zoteruara prej tij ne shoqeri, ortaket e tjere (ketej e tutje te quajtur Ortaket e tjere) gezojne te drejten e parablerjes mbi kuotat qe ofrohen per transferim (ketej e tutje te quajtur Kuotat e ofruara), sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:
- a. Ofruesi do tu dergoje fillimisht ortakeve te tjere ekzistues nje njoftim me shkrim (poste rekomande) ku te percaktohet numri i kuotave te oftuara, si dhe cmimin e kuotave te ofruara, emrin e bleresit dhe kushtet e tjera kontraktuale te transferimit (ketej e tutje referuar si oferta) duke ftuar se pari ortaket ekzistues te blejne keto kuota te ofruara.
 - b. Ortaket e tjere kane te drejte te blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, ne perpjestim me perqindjet e zoteruara e zoteruara, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati 30 ditor pas marrjes se njoftimit te ofruesit me poste rekomande.
- 7.3 Ne rast se nje apo disa nga ortaket ekzistues nuk perjigjen gjate afatit te mesiperme apo perjigjen ne menyre negative, atehere ofruesi eshte i lire ne transferimin e kuotave ne favor te paleve te treta pa kufizim, me kushte te njejtë si ato te parashikuara ne oferten e mesiperme.
- 7.4 Parashikimet sa me siper nuk zbatohen ne rastin kur kuotat transferohen ndermjet ortakeve ekzistues apo tek personat e paralindur apo paslindur ne vije te drejte te ortakeve ekzistues (femije, bashkeshorte).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruves të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqeria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkua nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë nga shoqeria likuidimin e saj, ne vlore te percaktuar nga ekspert perkates.



Kreu IV
Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
 - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
 - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
 - n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij nenit, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht."

- 9.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me leter rekomande apo poste elektronike me njoftim marrje, te derguar ne adresen e ortakeve. (te depozituara rregullisht nga ortaket prane administratorit). Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përparrat datës së caktuar pér mbledhjen përvç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga te gjithe ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permbaje ne menyre te qarte daten, diten, kohen, vandin dhe rendin e dites te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.



Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejtë procedure njoftimi që pershkruhet me siper.

Neni 10
Kuorumi i nevojshem

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve te zakonshme, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zoterojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.2** Në rastin e marrjes së vendimeve te jashtezakonshme, që kerkojne një shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme nëse marrin pjesë dhe jane te pranishem qofte dhe nepermjet perfaqesuesve te autorizuar, ortakët me të drejtë vote, te cilet zoterojnë jo me pak se 51 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11
Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Përgjithshme mund te marre vendime te jashtezakonshme me ane te votes pro te nje shumice prej 3/4 të ortakeve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se përgjithshme rregullisht te mbledhur për ceshtje te rendesishme që kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e Përgjithshme mund te marre vendime te zakonshme me anen e votes pro te shumices te ortakeve pjesmarres ne mbledhjen e asamblese se përgjithshme, rregullisht te mbledhur, dhe vecanerisht mbi ceshtjet e me poshtme:
 - a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakeve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes se asamblese se përgjithshme do te jetë administratori i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve



A handwritten signature in black ink, appearing to read 'L. Gj' or similar initials.

pjesemarres edhe një person tjeter për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se pergjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjt Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 12
Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjt per shoqerite tregtare ne fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V
Administratori

Neni 13
Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emëritet do të janë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve ne Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "**CONSOLIUM GROUP**" SHPK:
- **Florjan Malaj**, atësia **Nuredin 1** datelindjes 25-09-1992, lindur në Fier dhe banuese në Fier, shtetas Shqiptare, madhore e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtese e Leternjoftimit nr. Personal 033244990;
- per një afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti pranë Qendres Kombetare te Regjistrimit.**

Neni 14
Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me siper dhe ligjt tregtar ne fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me siper, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompenteca:
- (i) do te drejoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
 - (ii) do te nenshkruejte cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
 - (iii) do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke qe kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashte saj,



A handwritten signature in black ink, appearing to be a stylized 'G' or similar character, is placed here.

- (iv) do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijoje nje barre mbi pasurite e Shoqerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoqerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuara shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
- (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoqerise – duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoqerise;
- (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (viii) do te krijoje nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjt nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xi) do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
- (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xiii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.
- (xiii) Do te administroje adresat dhe kontaktet e ortakeve. Ne cdo rast ortaket jane te detyruar qe menjehere pas cdo azhornimi te kontakteve te tij (nr.tel, email, adrese shtepie) te njoftoje administratorin me shkrim, ne te kundert mban perjegjesi per cdo dem te shkaktuar nga mosnjoftimi ne kohe.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me siper, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15
Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuau ose mund të vuajë nga çrrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njofuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16
Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit per shoqerite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqerie, ne baze te kuorumi te kerkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI
Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimitarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga nen 3/1 te ligjit per shoqerite tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.



- 17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpérndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3** Administratori eshte i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me perjashtim te rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata qe i dergon njoftimin QKR-se.

Neni 18
Njoftimet

- 18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të janë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19
Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 19.2** Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punes dhe cdo akt tjeter ligor dhe nenligor te zbatueshem te Republikës se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 19.3** Viti finanziar zgjat 12 (dymbedhjete) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Ne fund te cdo viti finanziar, Administratori harton bilancin vjetor dhe reportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 19.5** Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare ne fuqi, te azhornuar.




NENI 20
Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me nje statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 20.2** Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjisacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.

Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga palet pa asnje rezerve.

ORTAKU THEMELUES


Florjan MALAJ